



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 26.5.2026

Nr. 1289

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së Komisionit Rregullator

E nderuar Kryetare e Komisionit Rregullator,

Të nderuar anëtarë,

Në mbështetje të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 19, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri vë në lëvizje Komisionin Rregullator sa herë që paraqiten çështje të kompetencës së tij.

Ju vë në dijeni se është përgatitur projektvendimi si vijon:

1. Projektvendim "Për miratimin e rregullave të procedurës së mbledhjes së nënshkrimeve për referendumet dhe nismat ligjvënëse".

Propozoj thirrjen e mbledhjes së Komisionit Rregullator për shqyrtimin e këtij projektvendimi.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të projektvendimit dhe relacionit shoqërues.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Ligjshmërisë

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIM
PËR

MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROCEDURËS SË MBLEDHJES SË
NËNSHKRIMEVE PËR REFERENDUMET DHE NISMAT LIGJVËNËSE

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN
NË FUQI

Referuar nenit 20, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Rregullator shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë së është në kompetencë të Komisionit Rregullator për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi “Për miratimin e rregullave të procedurës së mbledhjes së nënshkrimeve për referendumet dhe nismat ligjvënëse” hartohet me qëllim përcaktimin e rregullave të hollësishme procedurale që do të ndiqen për organizimin, administrimin dhe verifikimin e procesit të mbledhjes së nënshkrimeve nga zgjedhësit, në funksion të ushtrimit të së drejtës kushtetuese për referendum dhe për nismat ligjvënëse.

Ky projektvendim synon të garantojë zhvillimin e një procedure të qartë, transparente, të standardizuar dhe të zbatueshme në praktikë, duke siguruar respektimin e parimeve të ligjshmërisë, barazisë së qytetarëve përpara ligjit, integritetit të procesit dhe mbrojtjes së të dhënave personale të zgjedhësve.

Gjithashtu, projektvendimi synon të unifikojë praktikat administrative që lidhen me administrimin e formularëve të nënshkrimeve, mënyrën e identifikimit të mbështetësve, procedurat e dorëzimit dhe verifikimit të nënshkrimeve, si dhe detyrimet e subjekteve përgjegjëse për administrimin e procesit.



Projektvendimi mbështetet në dispozitat ligjore të përcaktuara në pjesën nëntë të ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” si dhe në ligjin nr. 54/2019 “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”.

Nevoja për miratimin e këtij projektvendimi lind nga domosdoshmëria për të pasur një kuadër të plotë dhe të detajuar procedural lidhur me mbledhjen e nënshkrimeve për referendumet dhe nismat ligjvënëse, me qëllim shmangien e paqartësive administrative dhe garantimin e zbatimit të njëtrajtshëm të legjislacionit në fuqi.

Projektvendimi rregullon procedurat për mbledhjen e nënshkrimeve në kuadër të referendumeve dhe nismave ligjvënëse, duke përcaktuar vendet e autorizuara për zhvillimin e këtij procesi, si dhe kërkesat lidhur me formën, përmbajtjen dhe mënyrën e administrimit e plotësimin të fletëve të nënshkrimeve.

Projektvendimi parashikon rregulla të detajuara mbi mënyrën e mbledhjes dhe administrimit të nënshkrimeve për referendumet dhe nismat ligjvënëse. Në mënyrë të veçantë, përcaktohet përdorimi i detyrueshëm i fletëve tip të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përmbajtja e tyre, të dhënat identifikuese që duhet të plotësohen nga zgjedhësit, si dhe elementet që lidhen me identifikimin dhe përgjegjësinë e anëtarëve të grupit të mbledhjes së nënshkrimeve.

Po ashtu, projektvendimi parashikon edhe rregullat për mbledhjen e nënshkrimeve në mënyrë elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për nënshkrimin elektronik, dokumentin elektronik dhe identifikimin elektronik, duke garantuar respektimin e standardeve dhe kërkesave për të dhënat që duhet të përmbajnë formularët përkatës.

Për sa më sipër, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i propozon Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim, projektvendimin “Për miratimin e rregullave të procedurës së mbledhjes së nënshkrimeve për referendumet dhe nismat ligjvënëse”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Tiranë më

protdate

Nr.

protnumber

Data: DD MM VVVV

Nr:000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROCEDURËS SË MBLEDHJES SË
NËNSHKRIMEVE PËR REFERENDUMET DHE NISMAT LIGJVËNËSE**

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja "a", dhe pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, pjesës njëmbëdhjetë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pjesës nëntë të ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", si dhe ligjit nr. 54/2019 "Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

Neni 1

Qëllimi

Ky vendim përcakton rregullat dhe procedurat për mbledhjen, administrimin dhe verifikimin e nënshkrimeve për referendumet dhe nismat ligjvënëse, si dhe përgjegjësitë e organeve dhe subjekteve të përfshira në këtë proces.

Neni 2

Rregulla të përgjithshme

1. Procesi i mbledhjes së nënshkrimeve për referendumet dhe nismat ligjvënëse zhvillohet në përputhje me parimet e ligjshmërisë, transparencës, paanshmërisë dhe garantimit të së drejtës së pjesëmarrjes së zgjedhësve.
2. Nënshkrimet mblidhen vetëm nga zgjedhës që gëzojnë të drejtën e votës, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Çdo nënshkrim duhet të jetë i identifikueshëm, i administruar në formatin e miratuar dhe i shoqëruar me të dhënat e nevojshme për verifikimin e vlefshmërisë së tij.
4. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) administron procesin e depozitimit dhe verifikimit të nënshkrimeve, sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim.

Data: dd mmvvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm



"Për miratimin e rregullave të procedurës së mbledhjes së nënshkrimeve për referendumet dhe nismat ligjvënëse"

5. Të dhënat personale të zgjedhësve që përfshihen në procesin e mbledhjes dhe administrimit të nënshkrimeve trajtohen dhe mbrohen në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 3

Përkufizime

1. “Referendum” është ushtrimi i drejtpërdrejtë i sovranitetit nga zgjedhësit, nëpërmjet votimit popullor, për një çështje ose ligj të caktuar, sipas rasteve dhe procedurave të parashikuara në Kushtetutë dhe në legjislacionin përkatës.
2. “Nismë ligjvënëse e zgjedhësve” është propozimi në formë të shkruar i një projektligji, i nënshkruar nga jo më pak se 20 000 zgjedhës, drejtuar Kuvendit të Shqipërisë.
3. “Grupi nismëtar për referendum” është një grup prej jo më pak se 12 personash me të drejtë vote, të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve, që organizohen për të nisur procedurat e referendumit dhe për të paraqitur kërkesën përkatëse pranë KQZ-së.
4. “Përfaqësia/Komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse të zgjedhësve” është bashkimi i zgjedhësve dhe/ose organizatave të shoqërisë civile që iniciojnë një nismë ligjvënëse dhe përfaqësohen nga përfaqësia ose komiteti përfaqësues i nismës.
5. “Grupi i mbledhjes së nënshkrimeve” është struktura përgjegjëse për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse, në mjediset publike dhe private.
6. “Mjedise të mbledhjes së nënshkrimeve” janë hapësirat publike ose private, me adresë dhe të numërtuara, ku realizohet procesi i mbledhjes së nënshkrimeve të mbështetësve të nismës.
7. “Verifikim i nënshkrimeve” është procesi i verifikimit të fletëve të nënshkrimeve, nënshkrimeve elektronike, si dhe i të dhënave të mbështetësve, që realizohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
8. “Fletët e mbledhjes së nënshkrimeve” janë fletë tip për mbledhjen e nënshkrimeve, të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
9. “Zgjedhës” është çdo shtetas me të drejtë vote, sipas nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Mbledhja e nënshkrimeve

1. Mbledhja e nënshkrimeve për referendumet dhe nismat ligjvënëse kryhet vetëm pas miratimit të regjistrimit të nismës nga KQZ.
2. Nënshkrimet mblidhen nga grupi nismëtar/komiteti përfaqësues dhe/ose nga persona të autorizuar prej tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe këtë vendim.
3. Çdo person i autorizuar për mbledhjen e nënshkrimeve duhet të jetë zgjedhës me të drejtë vote dhe të identifikohet në mënyrë të qartë përmes dokumentit të autorizimit të lëshuar nga grupi nismëtar.
4. Mbledhja e nënshkrimeve kryhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke garantuar që zgjedhësi të nënshkruajë vullnetarisht dhe personalisht.
5. Ndalohet ushtrimi i çdo forme presioni, ndikimi të padrejtë, premtimi për përfitim ose nxitje materiale në këmbim të nënshkrimit.
6. Zgjedhësi mund të mbështesë vetëm një herë të njëjtën nismë ligjvënëse ose referendum.

Neni 5

Vendet e mbledhjes së nënshkrimeve

1. Nënshkrimet mund të mblidhen në mjediset publike dhe private të hapura për publikun, të përcaktuara nga grupi nismëtar/komiteti përfaqësues.
2. Mjediset e mbledhjes së nënshkrimeve duhet të jenë të identifikuar qartë dhe të aksesueshme për zgjedhësit.

3. Ndalohet mbledhja e nënshkrimeve në mjedise që pengojnë lirinë e zgjedhësit për të shprehur vullnetin e tij të lirë.
4. Grupi nismëtar/komiteti përfaqësues është përgjegjës për garantimin e rendit dhe respektimit të rregullave në vendet e mbledhjes së nënshkrimeve.

Neni 6

Forma dhe plotësimi i fletëve të nënshkrimeve

1. Nënshkrimet mblidhen vetëm në fletët tip të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
2. Fleta tip e mbledhjes së nënshkrimeve për nismën ligjvënëse, në njëërën anë përmban informacionin mbi nismën ligjvënëse që do t'i propozohet Kuvendit, qëllimin dhe një shpjegim të përmbledhur të saj, si dhe të dhëna për përfaqësinë/komitetin përfaqësues të nismës. Në anën tjetër, fleta e mbledhjes së nënshkrimeve përmban:
 - a) numrin rendor;
 - b) gjenealitetet e zgjedhësit që mbështet nismën;
 - c) vendin dhe datën e lindjes;
 - ç) numrin e kartës së identitetit apo të pasaportës të vlefshme të zgjedhësit;
 - d) kolonën për nënshkrimet e zgjedhësve;dh)hapësirën përkatëse për emrin dhe mbiemrin e anëtarëve të grupit të mbledhjes së nënshkrimeve që përfshihen në procesin e mbledhjes së nënshkrimeve, ku ata nënshkruajnë për faktin që kanë realizuar këtë proces.
3. Fleta tip e mbledhjes së nënshkrimeve për referendum përmban titullin e ligjit, dispozitat që kërkohen të shfuqizohen ose çështja që shtrohet në referendum. Në vijim, fleta e mbledhjes së nënshkrimeve përmban:
 - a) numrin rendor;
 - b) gjenealitetet e zgjedhësit që mbështet nismën;
 - c) vendin dhe datën e lindjes;
 - ç) numrin e kartës së identitetit apo të pasaportës të vlefshme të zgjedhësit;
 - d) kolonën për nënshkrimet e zgjedhësve;dh)hapësirën përkatëse për emrin dhe mbiemrin e anëtarëve të grupit të mbledhjes së nënshkrimeve që përfshihen në procesin e mbledhjes së nënshkrimeve, ku ata nënshkruajnë për faktin që kanë realizuar këtë proces.

Neni 7

Dorëzimi i nënshkrimeve

1. Nënshkrimet e mbledhura dorëzohen pranë KQZ nga grupi nismëtar/komiteti përfaqësues ose përfaqësuesi i tyre i autorizuar.
2. Dorëzimi i nënshkrimeve bëhet brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi ose në vendimin e regjistrimit të nismës.
3. Nënshkrimet dorëzohen në formë fizike dhe/ose elektronike.
4. Në momentin e dorëzimit mbahet procesverbal, i cili pasqyron numrin e fletëve, numrin e përafërt të nënshkrimeve dhe identitetin e dorëzuesit.

Neni 8

Verifikimi i nënshkrimeve

1. Verifikimi i nënshkrimeve kryhet nga administrata e KQZ, e cila verifikon 5 (pesë) për qind të listës mbështetëse të paraqitur.

2. Pas përfundimit të verifikimit administrativ, administrata e KQZ-së harton një raport të detajuar mbi mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara gjatë procesit të verifikimit.
3. Raporti i verifikimit shqyrtohet në seancë publike të KSHZ-së, në prani të palës së interesuar.
4. Në përfundim të shqyrtimit, KSHZ vendos për pranimin ose refuzimin e listës mbështetëse të nënshkrimeve.
5. Lista e nënshkrimeve mbështetëse pranohet në rast se numri i nënshkrimeve të vlefshme, pas përjashtimit të nënshkrimeve të parregullta, është të paktën sa numri minimal i kërkuar nga legjislacioni në fuqi.
6. Në përfundim të procesit të verifikimit, KSHZ miraton aktin përkatës administrativ.
7. Kundër aktit administrativ të KSHZ-së mund të bëhet ankim nga subjekti i interesuar në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS).

Neni 9

Mbledhja e nënshkrimeve elektronike

1. Mbledhja e nënshkrimeve në mënyrë elektronike kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për nënshkrimin elektronik, dokumentin elektronik dhe atë për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.
2. Në mbledhjen e nënshkrimeve elektronike respektohen, për aq sa është e mundur, kërkesat e këtij vendimi, për të dhënat që duhet të përmbajë fleta tip e mbledhjes së nënshkrimit.

Neni 10

Pavlefshmëria e nënshkrimeve

1. Konsiderohen të pavlefshme nënshkrimet që:
 - a) nuk janë të shoqëruara me të dhënat e kërkuara sipas këtij vendimi;
 - b) janë të përsëritura nga i njëjti zgjedhës për të njëjtën nismë;
 - c) janë të dhëna nga persona pa të drejtë vote;
 - ç) janë plotësuar në kundërshtim me procedurat e përcaktuara.
2. Nënshkrimet e pavlefshme nuk përfshihen në llogaritjen e numrit minimal të kërkuar sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 11

Dispozitat Përfundimtare

1. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Kryetar
Ilirjana NANO

Anëtar
Arben RISTANI

Anëtar
Bledar SKËNDERI



**Anëtar
Helga VUKAJ**

**Anëtar
Dritan ÇAKA**

Data: dd mmvvvNr: 123-456
Ora: hh:mm



"Për miratimin e rregullave të procedurës së mbledhjes së nënshkrimeve për referendimet dhe nismat ligjvënëse"